



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1009 Prot.

Tiranë, më 17. 2. 2023

URDHËR
Nr 63, datë 17.2.2023

PËR
CAKTIMIN E MASAVE PËR ZBATIMIN E SË DREJTËS SË INFORMIMIT
NDAJ PUBLIKUT

Në zbatim të neneve 7, 8, 10, 19 të ligjit nr.119, datë 18.9.2014 “Për të drejtën e informimit” (LDI), Udhëzimit nr. 47, datë 14.9.2018 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”, si dhe pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Caktohen znj.Olsa Brati dhe/ose znj.Aldona Luari, Koordinator/e për të Drejtën e Informimit në ILDKPKI, në përputhje me pikën 6 të nenit 2 të ligjit nr.119, 18.9.2014 “Për të drejtën e informimit”.
2. Caktohet z. Emiljano Kondi, Nëpunës i Mbrojtjes së të Dhënave.
3. Urdhri nr. 555, datë 11.5.2022 shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Eygjeni BASHARI

